| <p><b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit :</b> Strategjia aktuale e BE-së e vlerëson efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, si një prioritet për zhvillimin ekonomik dhe të përgjithshëm të çdo vendi. Si anëtarë të Komunitetit të Energjisë dhe angazhimeve të tjera të marra prej saj, Shqipëria është e angazhuar për të ndjekur këtë prioritet duke adoptuar legjislacionin në përputhje me Acquis të BE për Efikasitetin e Energjisë, Energjitik të Rinovueshme etj, dhe të përgatisë periodikisht Planet Kombëtare të Veprimit, monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e objektivave të energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë dhe reduktimit të emetimeve të gazrave me efekt serë. Objektivi konkret afatmesëm i vendosur nga Qeveria Shqiptare në këtë kontekst, është ulja e konsumit të energjisë prej 9% deri në vitin 2018.</p> <p>Në zbatim të këtyre detyrimeve, në nëntor 2015, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 124 dt. 05.11.2015 "Për efikasitetin e energjisë", si mekanizëm për transpozimin e Direktivës 2012/27 të BE "Për Efikasitetin e Energjisë", si hap të parë drejt transpozimit të plotë të direktivave të BE-së për efikasitetin e energjisë. i botuar në Fletoren Zyrtare numër 201, të 24 nëntor 2015, ky ligj ka hyrë në fuqi në 9 Dhjetor 2015 duke parashikuar që të sillte rezultatet e para dhe ngritjen e institucioneve të reja brenda 12 muajve në vijim.</p> <p>VKM nr. 619 datë 07.09.2011 " Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë , 2011-2018"<br/>VKM nr. 628 datë 15.07.2015 " Për miratimin e Rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve".</p> <p>Projekti "Bashki të Zgjuara Energjie" (PBZE) synon të përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë, të zvogëlojë konsumin e energjisë, të promovojë burimet e energjisë së rinovueshme duke promovuar përdorimin e teknologjive energjitike inovatore dhe miqësore me mjedisin.</p> <p>Projekti konsiston në vlerësimin e konsumit energjetik në ndriçimin publik (si një nga sektorët me konsum më të madh të energjisë elektrike) dhe dhënien e zgjidhjeve efikente të të përmirësimit të situatës energjitike duke përdorur teknologjinë ekologjike, në reduktim maksimal konsumit aktual dhe duke ndikuar ndjeshëm në uljen e kostos së ndriçimit si dhe duke ndikuar indirekt në uljen e përgjithshme të CO<sub>2</sub> në atmosferë.</p> <p>Ky projekt nisi me iniciativën e Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështje Ekonomike (SECO), cili përmes një mekanizmi seleksionimi, përzgjedhi Bashkinë Shkodër si një ndër katër bashkitë fituese për implementimin e këtij projekti.</p> <p>Projekti ka nisur me përzgjedhjen e rrugëve që do të nënshtrohen ndërhyrjes. Përzgjedhja e rrugëve është bërë duke marrë parasysh pozicionimin dhe frekuentimin e rrugëve kryesore të qytetit, në mënyrë të atillë që projekti të ketë një impakt sa më të lartë tek ajo pjesë e qytetit që ka një dendësi më e madhe dhe duke patur për qëllim realizimin e një ndriçimi sa më uniform brenda qendrës së qytetit të Shkodrës.</p> <p>Në fazën e parë të projektit (2020 - 2021), u realizuan auditimet energjitike të ndriçimit publik i rrugëve të përzgjedhura duke analizuar humbjet ekzistuese energjitike dhe duke ofruar zgjidhjet optimale për zëvendësimin e tyre me ndriçues me efikasitet të lartë energjitike.</p> <p>Nga analiza e përgjithshme e auditimeve energjitike të rrugëve u vlerësua se ndriçuesit ekzistues kishin rënie të ndriçimit duke i klasifikuar ato si jo efikente. Nga auditimi energjitik vlerësohet se ndriçuesit ekzistues me fuqi 250 W SAP SON (high pressure lamp) mund të zëvendësohen me ndriçues LED me fuqi 80 W, duke ulur konsumin e energji elektrike me rreth tre herë me pak për çdo ndriçues. Duke marrë në konsideratë zëvendësimin e rreth 600 ndriçuesve, do të kemi një situatë të për mirësuar energjitike me rreth 400 000 kWh më pak në vit ose me rreth 6,000,000 lekë më pak në vit.</p> <p>Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes SECO, Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe Bashkisë Shkodër në nëntor të vitit 2021, do të nis puna për hartimin e projekteve teknike për implementimin e tyre.</p> <p>Gjatë vitit 2022 do të zbatohen katër projektet e para, ku sipas një radhe të dakortësuar do të fillohet me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rruga pedonale "Gjuhadol" (zona historike e qytetit), duke vazhduar me</li> <li>2. Bulevardi "Zogu i Parë",</li> <li>3. Rrugën "Studenti" dhe</li> <li>4. Rrugën "Eilson".</li> </ol> <p>Keto rrugë janë përzgjedhur me arsyetimin se përfaqësojnë rrugët më kryesore të qytetit, me një frekuentim të lartë nga qytetarët dhe me konsum të madh energjie, ku implementimi i projektit do të sjellë një impakt të madh si në kursimin e energjisë ashtu edhe në përmirësimin vizual të rrugëve.</p> <p>Gjatë vitit 2023 do të zbatohen katër projekte të tjera për rrugët :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bulevardi "Mehmet Pashë Plakut",</li> <li>2. Rruga "Marin Bicikemi",</li> <li>3. Rruga "Edith Durham" dhe</li> <li>4. Bulevardi "Skenderbeu".</li> </ol> <p>Gjatë vitit 2024 do të zbatohen projektet e tjera për rrugët e mbetura,</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bulevardi "Bujar Bishanaku"</li> <li>2. Rruga "Daut Boriçi",</li> <li>3. Rruga "Kole Heqimi",</li> <li>4. Rruga "Mbreti Gent",</li> <li>5. Rruga "Agron".</li> </ol> <p>Projekti do të zbatohet nga Bashkia Shkodër me bashkëfinancim të SECO (Sekretariatit Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike), ku SECO kontribuon me 291,000 CHF (33,473,215 lek) dhe Bashkia Shkodër do të kontribuojë me 60 000 CHF (6,972,000 lek).</p> |   |  |

Njëkohësisht projekti do të mbështesë punën për hartimin e Planit të Eficencës Energjise për Bashkinë Shkodër.



#### i. Situata

Ne vitin 2018 në bashkëpunim me GIZ Albania, bashkia Shkodër në kuadër të projektit për modernizimin e ndricimit me eficiencë të lartë të energjisë elektrike në shëtitoret pedonale në Qytetin e Shkodrës, ka aplikuar zëvendësimin ndriçuesve SAP SON (high pressure) 150 Ë e rrugëve "13 dhjetori" dhe "28 nentori" me ndriçues LED 30Ë, duke i sjelle një kursim të energjisë me rreth 5 here per ndriçues.

Gjithashtu në investimet e reja të rrugëve ka nisur aplikimi i ndriçuesve LED duke sjellë një situatë më të përmirësuar energjitike në ndriçimin publik.

Ministria e infrastrukturës dhe energjisë ne bashkëpunim me SECO (Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet ekonomike) fton Bashkinë Shkodër nëpërmjet email-it të datës 21 korrik 2019 për të qënë pjesë e iniciativës së re të përbashkët projekti: Bashki të zgjuara Energjie (PBZE). Më 25.07.2019 Bashkia Shkodër pranoi ftesën duke dërguar letrën e interesit ku shpreh interesin e saj për të qënë një nga bashkitë Pilot të këtij projekti.

Më 07.11.2019 Amabasada e Zvicrës në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë , nëpërmjet shkresës me nr.9717/1 Prot., fton Bashkine Shkodër të marr pjesë ne fazën e dytë të përzgjidhjes së 8 bashkive nga 20

bashkitë kandidatë në projektin "Bashki të Zgjuara Energjie", ku nëpërmjet një pyetësori informues në lidhje me konsumin dhe administrimin e energjisë nga Bashkia Shkodër.

Në përgjigje të kësaj ftese Bashkia Shkodër nëpërmjet shkresës me nr.19441/1 Prot., datë 27.11.2019 shpreh gadishmërinë e saj për vijuar në fazën tjetër të përzgjedhjes duke dërguar bashkëlidhur pyetësoarin e plotësuar në lidhje me konsumin dhe administrimin e energjisë në Bashkinë Shkodër.

Më 03.02.2020 nëpërmjet email-it zyrtar Bashkia Shkodër njoftohet se është një nga 8 bashkitë e përzgjedhura nga 21 bashki.

Për fazën e tretë të përzgjedhjes (nga 8 në 4 bashki fituese), ekipi i konsulencës së bashku me SECO parashikon zhvillimin e një takimi zyrtar në Bashkinë Shkodër me 13.02.2020 ku do të takohet me Kryetaren e Bashkisë dhe ekipin e punës pranë Bashkisë Shkodër ku do të trajtohen çështjet kryesore në lidhje me energjinë në Bashkinë Shkodër, të cilat do të jenë kriter përzgjedhës për shpalljen fitues të projektit.

Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) me 16 prill 2020 njofton shpalljen e Bashkisë Shkodër si një ndër katër Bashkitë Fituese të këtij projekti.

Bashkia Shkodër falënderoj donatorët për shpalljen e saj si një ndër katër bashkitë fituese dhe garanton një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe efektiv deri në përfundimin me sukses të këtij projekti.

Donatori: Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, SECO (Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet ekonomike), financues kryesor

Bashkëfinancues : Bashkia Shkodër

Buxheti i Projektit ( për 4 bashki) do të ketë një vlerë totale prej 759.000 CHF ( rreth 87.894.817 lekë) prej të cilave :

Kontributi Total SECO do të jetë 582.000 CHF ( rreth 67.397.607 lekë).

Kontributi total minimal i domosdoshëm i kërkuar nga Bashkia 177.000 CHF ( rreth 20.497.210 lekë)

Kontributi i kërkuar nga Bashkia në formë kesh-i 60.000 CHF ( **6.972.000 lekë**)

Kontributi i kërkuar nga Bashkia me punë in kind 117.000 CHF ( rreth 13.549.003lekë)

Kontributi total i SECO në % 76.66%

Kontributi i kërkuar Bashkisë në formë kesh shprehur në % është 7.91%

Kontributi i kërkuar Bashkisë me punë in kind shprehur në % është 15.42%

Pjesa e parë e Kontributit grant SECO do të jetë 291.000 CHF ose **33.473.215 lekë.**

Pjesa e dytë në po të njëjtën sasi (291.000 CHF ose **33.473.215 lekë**) do të jepet në fazën e dytë.

Në bashkëpunim u përzgjedhën 10 akse rruge për të cilat do të kryhen Auditimet Energjetike dhe mbas analizës së hollësishme do të vendoset se cilat rrugë do të jenë pjesë e investimit.

U arrit në përfundimin se rrugët të cilat do të Auditohen dhe më pas të planifikohen për ndërhyrje janë akset rrugore të cilat kanë edhe konsumin e energjisë më të madh si edhe akset rrugore të cilat kanë nevojë për investime.

## ii. Synimi i projektit

Synimi kryesor i tij është që të përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë, duke ulur konsumin vjetor të energjisë, duke sjellë një situatë me të mirë energjitike, kosto më të ulët të ndriçimit publik sidhe përmirësimin e këtij shërbimi.

Me anë të këtij projekti synohet të arrihet një ndriçim standart, duke garantuar uniformitet, komfort dhe jetëgjatësi me të madhe të ndriçimit.

Me kursimin e energjisë indirekt synohet të ndikohet tek ulja emetimeve të gazeve serë.

Me anë të këtij projekti synohet që të krijohet një qasje e re në raport me konsumin energjitik në ndriçimin publik duke ndryshuar sjellje në raport me efincensën energjitike duke hapur një kapitull të ri në menaxhimin e energjisë në sektorin publik.

Gjithashtu projekti synon hartimin e e Planit të Efiçencës së Energjisë për Bashkinë Shkodër, si një dokument që do të garantojë vijimësinë e projeteve/ investimeve në funksion të efiçencës së energjisë.

## iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Auditimi energjitik i ndriçimit publik në rrugët e perzgjedhura
- Përzgjedhja dhe hartimi i projekteve teknike për zbatimin e tyre.
- Zbatimi i projekteve sipas rradhës së dakortësuar
- Hartimi i Planit të Efiçencës së Energjisë, Bashkia Shkodër.

## b) Rezultatet që prisni

- Krijimi dhe forcimi i njësive të menaxhimit të energjisë në mënyrë të qëndrueshme në nivel bashkiak.
- Zhvillimi i Planeve të Energjisë Bashkiake për 4 bashkitë pilot. .
- Realizimi i investimeve me periudhë zbatimi shumë të shpejtë në bashkitë pilot.
- Forcimi i institucioneve kyçe në lidhje me menaxhimin e energjisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë dhe vendim-marrësve në bashki.
- Përgatitja e Programit Shqiptar të Menaxhimit të Energjisë me mundësitë potenciale për tu shtrirë në nivel kombëtar

## c) Aktoret e mundshëm

Bashkia Shkodër  
Ministria e Mjedisit e Turizmit, Ministria e Infrastrukturës e Energjisë  
Agjensia Kombetare e Mjedisit  
Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Shkodër  
Shoqatat Mjedisore  
Subjekte private  
Banorët e Bashkisë Shkodër

## d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër, SECO



| e) Shpenzimet e llogaritura       |  |  |           |           |               |
|-----------------------------------|--|--|-----------|-----------|---------------|
| Shpenzimet për çdo aktivitet 2022 |  | Totali<br>(000 lekë)                           | Nga kjo:  |           |               |
|                                   |  |  | Paga, sig | Operative | Kapitale      |
| A.1                               | <b>Projektim në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie</b><br>1. Rruga pedonale "Gjuhadol"<br>2. Bulevardi "Zogu i Pare"<br>3. Rruga "Studenti"<br>4. Rruga "Eilson".  |  |           |           |               |
| A.2                               | <b>Mbikqyrje dhe Kolaudim investimi në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie</b>  |  |           |           |               |
| A.3                               | <b>Investime në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie</b><br>1. Rruga pedonale "Gjuhadol"<br>2. Bulevardi "Zogu i Pare"<br>3. Rruga "Studenti"<br>4. Rruga "Eilson".  |  |           |           |               |
| <b>Shuma</b>                      |  |  |           |           |               |
| Shpenzimet për çdo aktivitet 2023 |  | Totali<br>(000 lekë)                           | Nga kjo:  |           |               |
|                                   |  |  | Paga, sig | Operative | Kapitale      |
| A.1                               | <b>Projektim/ investim në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie</b><br>1. Bulevardi "Mehmet Pashë Plakut",<br>2. Rr. "Marin Bicikemi"<br>3. Rr. "Edith Durham"<br>4. Bulevardi "Skenderbeu".                |  |           |           |               |
| A.2                               | <b>Mbikqyrje dhe Kolaudim investimi në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie</b>  |  |           |           |               |
| A.3                               | <b>Investime në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie.</b><br>1. Bulevardi "Mehmet Pashë Plakut",<br>2. Rruga "Marin Bicikemi"<br>3. Rruga "Edith Durham"<br>4. Bulevardi "Skenderbeu".                     | 33,473   |           |           | 33,473        |
| <b>Shuma</b>                      |  | <b>33,473</b>                                  |           |           | <b>33,473</b> |
| Shpenzimet për çdo aktivitet 2024 |  | Totali<br>(000 lekë)                           | Nga kjo:  |           |               |
|                                   |  |  | Paga, sig | Operative | Kapitale      |
| A.1                               | <b>Projektim/ investim në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie</b><br>1. Bulevardi "Bujar Bishanaku"<br>2. Rruga "Daut Boriçi",<br>3. Rruga "Kole Heqimi",<br>4. Rruga "Mbreti Gent",<br>5. Rruga "Agron". |  |           |           |               |
| A.2                               | <b>Mbikqyrje dhe Kolaudim investimi në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie</b>  |  |           |           |               |
| A.3                               | <b>Investime në kuadër të projektit Bashki të Zgjuara Energjie.</b><br>1. Bulevardi "Bujar Bishanaku"<br>2. Rruga "Daut Boriçi",<br>3. Rruga "Kole Heqimi",<br>4. Rruga "Mbreti Gent",<br>5. Rruga "Agron".          |  |           |           |               |
| <b>Shuma</b>                      |  |  |           |           |               |
| f) Periudha e zbatimit            |  | g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |           |           |               |

Janar 2022- Dhjetor 2022  
Janar 2023- Dhjetor 2023  
Janar 2024-Dhjetor 2024

Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

**Institucion Likujdues:** Bashkia Shkodër





|  |   |   |           |           |
|--|---|---|-----------|-----------|
| <b>Nr.3</b>  | <b>P05320.O2.A1</b><br>Zbatimi i Planit të veprimit mbi zhurmat në Bashkinë Shkodër | <b>Funksioni 05:</b> Mbrojtja e Mjedisit<br><b>N/Funksioni 053 :</b> Reduktimi i ndotjes<br><b>Programi 05320:</b> Programet e mbrojtjes së mjedisit              |           |           |
| <b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit :</b> Projekti konsiston në zbatimin e disa masa përmirësuese të situatës së zhurmave urbane, të parashikuara në Planin e Veprimit të Planit e Lokal të Veprimit për Zhurmat në Mjedis, Bashkia Shkodër 2019.  |   |   |           |           |
| <b>i. Situata</b>  |   |   |           |           |
| Bazuar në Ligjin nr. 9774/2007” Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” është realizuar hartimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Zhurmat në Mjedis, e miratuar në Këshillin Bashkiak me vendim nr.22, datë 18.4.2019. Ndër të tjera Plani ka parashikuar disa masa , plane veprimi për zbatimin e këtij plani.  |   |   |           |           |
| <b>ii. Synimi i projektit</b>  |   |   |           |           |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëllimi kryesor është reduktimi dhe minimizimi i ndotjes akustike të gjeneruara nga zhurmat urbane ne Bashkinë Shkodër.</li> <li>• Zbatimin e dispozitave ligjore që ngarkon njësjive të qeverisjes vendore për marrjen e masave kundër zhurmave ne zonat urbane.</li> </ul>  |   |   |           |           |
| <b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>  |   |   |           |           |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërhyrja në infrastrukturën e ndërtesave (me materiale zë-izuluese)</li> <li>• Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore.</li> <li>• Ndertimi i i barrirave (natyrale &amp; artificiale) akustike.</li> <li>• Ndertimi i pistave të bicikletave</li> <li>• Vendosja e sinjalistikes rrugore për ndalimin dhe kufizimin e zhurmave.</li> </ul> |   |   |           |           |
| <b>b) Rezultatet që prisni</b>   |   |   |           |           |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ulja e nivelit të zhurmave, veçanërisht në pikat më problematike të indentifikuara.</li> </ul>  |   |   |           |           |
| <b>c) Aktoret e mundshëm</b>   |   | <b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>   |           |           |
| Bashkia Shkoder<br>Ministria e Mjedisit e Turizmit, Ministria e Infrastrukturës e Energjisë<br>Agjensia Kombëtare e Mjedisit<br>Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Shkodër<br>Shoqatat Mjedisore<br>Subjekte private<br>Banorët e Bashkisë Shkodër   |   | Bashkia Shkodër   |           |           |
| <b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>   |   |   |           |           |
| <b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2022</b>   |   | Totali<br>(000 lekë)  | Nga kjo:  |           |
| A.1  | Vendosja e sinjalistikes rrugore për ndalimin dhe kufizimin e zhurmave              | 0   | Paga, sig | Operative |
| <b>Shuma</b>   |   | <b>0</b>  |           |           |
| <b>Shpenzimet per çdo aktivitet 2023</b>   |   | Totali<br>(000 lekë)  | Nga kjo:  |           |
| A.1  | Ndërtimi i barrierave akustike.   | 0   | Paga, sig | Operative |
| <b>Shuma</b>   |   | <b>0</b>  |           |           |
| <b>Shpenzimet per çdo aktivitet 2024</b>   |   | Totali<br>(000 lekë)  | Nga kjo:  |           |
| A.1  | Ndërhyrja në infrastrukturën e ndërtesave (me materiale zë-izuluese)                | 0   | Paga, sig | Operative |
| <b>Shuma</b>   |   | <b>0</b>  |           |           |
| <b>f) Periudha e zbatimit</b><br>Janar 2022- Dhjetor 2022<br>Janar 2023- Dhjetor 2023<br>Janar 2024-Dhjetor 2024   |   | <b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b><br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave<br><b>Institucion Likujdues:</b> Bashkia Shkodër |           |           |

|             |   |  |
|-------------|---|--|
| <b>Nr.4</b> | <b>P05320.02.A2</b> Investim për sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor ("capping") të ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Dëshmoreve. | <b>Funksioni 05:</b> Mbrojtja e Mjedisit<br><b>N/Funksioni 053 :</b> Reduktimi i ndotjes<br><b>Programi 05320:</b> Programet e mbrojtjes së mjedisit |
|-------------|---|--|

**Përshkrimi i shkurtër i projektit:** Bazuar në Ligjin nr 10463/2011 " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar ( neni 3 pika 24), Ligji nr 107/2014 " Për planifikimin e territorit" i ndryshuar,VKM nr 418 dt 27.05.2020 " Miratimi i politikave strategjike dhe të planit kombëtar të mbetjeve 2020-2035" , VKM nr 575 dt 26.04.2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" , pika 14 e në vazhdim VKN nr 99/2005 " për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve " të ndryshuar kap 17, Bashkia Shkodër propozon " Investim për sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor ("capping") i ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Dëshmoreve."

Ky projekt konsiston kryerjen e disa punimeve për izolimin sipërfaqësor të ish fushës së mbetjeve urbane, me qëllim reduktimin e ndotjes së ajrit që vjen nga prezenca disa vjeçare e mbetjeve urbane.

Projekti synon të arrijë mbylljen dhe vënien në siguri të qëndrueshme të ish fushës së mbeturinave urbane Me anë të këtij projekti/ investimi do të arrihet, në përmirësimin e situatës higjieno/sanitare të fushës si dhe i ambientit përfaqë saj.

Në funksion të këtij qëllimi dhe në funksion të menaxhimit të mbetjeve inerte pranë fushës së mbetjeve do të ngrihet njësi e përkohshme e përpunimit të mbetjeve inerte të cilat do të përdoren për mbulimin (izolim) e mbetjeve urbane që ndodhen në fushën e ish vend-depozitimit të mbetjeve urbane. Zona ku do të ngrihet kjo njësi menaxhimi do të jete brenda sipërfaqes se ish fushës së vend-depozitimit dhe parashikon të ketë një sipërfaqe rreth 5500 m<sup>2</sup>.

Materiali i inerteve të përpunuara do të hidhen në grumbullin e mbetjeve urbane pasi ato të jenë sistemuar (rrafshuar) me një mjet teknologjik. Ky proces pune do të planifikohet për të patur një mbulim sa me të mirë të fushës së mbetjeve.

Me anë të kësaj ndërhyrje si qëllim final do të shënonim edhe përmirësimin e kushteve të jetesës se popullatës së qytetit si dhe të asaj pjese që jeton afër kësaj fushe.

Në saj të veçorisë që kjo fushë paraqet, ndërhyrja e propozuar, lidhet në mënyrë ideale pjesërisht me procedurën për mbylljen e një fushe depozitimi të mbetjeve urbane, si dhe pjesërisht me punimet për bonifikimin e një fushe të ndotur.

Mbështetur ne këto konsiderata si dhe në rezultatet karakterizuese të fushës, zgjidhja e propozuar, parashikon minimizim të impaktit të fushës në ambient, (ajër, ujë si dhe tokë dhe nëntokë) si dhe te rreziqeve për shëndetin, përgjatë gjithë ciklit kohor të ekzistencës se saj;

Investimi parashikon rrethim të zonës në këtë mënyre disiplinohet zona e depozitimit dhe përpunimit të inerteve , me pas do të ketë ndërhyrje sistemuase , ngjeshje dhe përhapje të materialeve ndërtimore ( dhera, inerte ) , sistemim i një sipërfaqeje mbi 10 mijë m<sup>2</sup> . Në kantjer do të instalohet në mënyrë të përhershme një buldozer , dhe do të ketë punetoret të cilët do të punojnë dhe sistemojnë ambientin. Vendi i rrethuar do të ketë ndricim dhe do të shoqërohet me kamera. Në këtë mënyre rritim edhe sigurinë në zonë që të mos ketë ndërhyrje/ depozitime të pa autorizuara.

Bazuar në VKM nr 575 dt 26.04.2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" pika 14 shprehimisht thote: Në vendin për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte, të depozitohen jo më tepër se 20 tonë në ditë ose 3 500 tonë në vit mbetje inerte. Afati i dorëzimit të mbetjeve inerte në venddepozitimin e përkohshëm të jetë deri në momentin e ndërtimit të lëndfillit për trajtimin e mbetjeve inerte në zonën më të afërt gjeografikisht të njësisë së qeverisjes vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose lëndfillt e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Referuar edhe materialeve qe gërmohen /transportohen gjatë punimeve të një Leje Ndërtimi kryesisht Pallat ku baza e një pallati është jo më e vogël se 500 m<sup>2</sup> rezulton që do të ketë një sasi material gërmimi prej rreth 2500m<sup>3</sup> ose 4000 ton , për të cilën zhvilluesi do të paguajë një tarifë depozitimit prej 4000 ton \*100 lek/ton =400.000 lek. Tarifë kjo e pranueshme për një investim të tillë. **Bashkia Shkodër propozon nje tarife prej 100 lekë/ton , për Zhvilluesit që pajisen me Leje Ndërtimi. Pra në këtë mënyrë Bashkia ndalon hedhjen e inerteve në mënyrë të paligjshme nga subjektet ndërtimore të cilët pajisen me Leje Ndërtimi nga Bashkia. Kjo tarifë shërben edhe për qytetaret të cilët prodhojnë inerte gjatë punimeve që kryejnë në banesat e tyre , punime të cilat nuk kërkojnë pajisje me leje ndërtimi, dhe transportin e kryejnë me automjet që e sigurojnë vetë në mënyrë private.**

Në mënyrë që të reduktojë sa më shumë hedhjen e inerteve në mënyrë të paligjshme Bashkia do të vendosë në shërbim të qytetarëve, që prodhojnë inerte si rezultat i punimeve që kryejnë punime të cilat nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe nuk kane automjet , nje automjet kundrejt një tarife prej 340 lek/ton Distanca deri në vendin e caktuar është 2.7 km pra rreth 3 km ( vajtje ardhje 6km) referuar VKM për miratimin e Manualeve të ndërtimit ( manuali nr 2)



|   |  |    |     |
|---|--|----|-----|
| 2.37/1b   | Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 6.0 km | m3 | 357 |
| Pra 357 lekë/m3 ose 234 lekë/ton transporti + 100 lekë/ton tarifa = 334 lekë/ton ose 340 lekë/ton |  |    |     |

Plan vendodhja e projektit



Mjete për rrafshimin dhe sistemimin e fushës së mbetjeve




i. Situata

Ish vend-depozitimi i mbetjeve pranë varrezave të dëshmorëve në Shkodër është një ndër hot-spotet mjedisore më të mëdha në Bashki. Pas mbylljes së tij (mos funksionimit) nuk janë marrë masat e nevojshme për rehabilitimin mjedisor. Duke u gjendur pranë Lumit Kir vazhdon të jetë burim i ndotjes dhe kontaminimi të tokës dhe lumit Kir. Megjithëse ekziston një projekt teknik për rehabilitimin mjedisor të gjithë ish vend-depozitimit, nuk është bërë i mundur pasi ka një kosto të madhe (rreth 270 000 000 lekë) e papërbalueshme për buxhetin e bashkisë Shkodër.

Kushtet e fushës janë alarmante. Ish fusha e depozitimit nuk ka asnjë kriter sigurie, po kështu edhe normat e karakterit higjieno/sanitar janë shqetësues. Hyrja në fushë bëhet direkt nga rruga pranë saj, nëpërmjet një pjese rruge të asfaltuar që të nxjerr në sheshin kryesor të lokalizuar pranë Varrezave të Dëshmoreve. Përgjatë gjithë perimetrit të murit rrethues të varrezave ekziston një kanal drenazhues në çimento për grumbullimin e ujërave të shirave, aktualisht pjesërisht funksional në sajë të mbeturinave që kanë depërtuar në të.

Në fushën e mbetjeve here pas here vihat re edhe prezenca e tymrave që vjen nga djegia e mbeturinave (kryesisht nga vetë-djegia e brendshme e tyre si pasojë e proceseve kimike). Kjo situatë është mjaft shqetësuese dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme për përmirësimin e saj.



Pamje nga ish vend-depozitimi i mbetjeve urbane

## ii. Synimi i projektit

Projekti synon arritjen e këtij objektiv:

**Objektivi:** Minimizim të impaktit të fushës në ambient, (ajër, ujë si dhe tokë dhe nëntokë) si dhe të rreziqeve për shëndetin, përgjatë ciklit kohor të ekzistencës së saj;

Projekti synon nisjen e punimeve për sistemimin dhe izolimin e fushës së mbetjeve për të minimizuar ndotjen e ajrit që vjen nga procesi i djegies së brendshme të mbeturinave si pasojë e reaksioneve kimike të zbërthimit të lëndës organike në biogaz dhe CO<sub>2</sub> si dhe minimizimin e aromave të këqija.

Pra me anë të këtij projekti do të arrihet përmirësimi i situatës higjieno/sanitare të fushës si dhe i ambientit përfaqë saj.

Aplikim të masave specifike për uljen në minimum të shqetësimeve dhe rreziqeve që vijnë nga fusha dhe që shkaktohen nga:

1. Prodhim të erërave dhe të pluhurave.
2. Materiale të transportueshëm nga era.
3. Zogjve, parazitëve dhe insekteve
4. formimit të aerosolit
5. zjarreve.

Ky investim/projekt do të përmirësojë situatën e menaxhimit të mbetjeve inerte (duke i përdorur për izolimin e mbetjeve fushës së mbetjeve), duke dhënë një zgjidhje të përkohshme deri në momentin e miratimit të vendëzimit të mbetjeve inerte.

Me anë të kësaj ndërhyrje si qëllim final do të shënonim edhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës së qytetit si dhe të asaj pjese që jeton afër kësaj fushe.

## iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Kufizim të zonës me qëllim pengimin e hyrjes të personale të pa autorizuar, duke mundësuar vendosjen e kushteve normale të sigurisë.
2. Rrafshimi i sipërfaqes së fushës së mbetjeve.
3. Rrethimi i zonës ku do të kryhen punimet.
4. Sistemim dhe përpunim i mbetjeve inerte.
  1. Shtresëzimi ngjeshja e mbetjeve inerte mbi fushën e mbetjeve urbane, në mënyrë që të arrihet izolimi i tyre.
  2. Rehabilitimi ambiental i zones do të kompletohet nga ndërhyrje për rimbjellje dhe riveshje me bar të sipërfaqes së fushës së mbrojtur. Rigjellbërimi duhet të bëhet nëpërmjet rimbjelljes së llojeve të bimëve autoktone me zhvillim rrënjesh jo më thellë se 80 cm me qëllim mos dëmtimit e shtresave të pa përshkueshme në thellësi.
  3. Preventivë vlerësues bashkëlidhur.

## b) Rezultatet që prisni

1. Nga ky projekt apo ndërhyrje pritet të kemi një situatë të përmirësuar mjedisore dhe kushte më të mira higjieno-sanitare.
2. Përmirësimi i situatës së menaxhimit të mbetjeve inerte.
3. Sistemim i territorit përreth varrezave të Dëshmorëve.
4. Përmirësimi i peisazhit përreth.
5. Ulje e ndotjes së ajrit përreth.
6. Për të gjithë subjektet që do të depozitojnë inerte në këtë fushë provizore bashkia do të aplikojë një tarifë prej 100 lek/ton.

|   |   |   |          |          |           |             |               |
|---|---|---|----------|----------|-----------|-------------|---------------|
| <b>c) Aktorët e mundshëm</b>  |   | <b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>   |          |          |           |             |               |
| Bashkia Shkodër   |   | Bashkia Shkodër   |          |          |           |             |               |
| <b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>  |   |   |          |          |           |             |               |
| <b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2022</b>  |   | Totali<br>(mijë lekë)   | Nga kjo: |          |           |             |               |
|   |   |   | Paga     | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale      |
| A.1   | Investim për sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor ("capping") të ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Dëshmoreve. | 11,228  |          |          |           |             | 11,228        |
| A.2   | Blerje buldozer   | 1,000   |          |          |           |             | 1,000         |
| A.3   | Blerje Veshje për punëtorët   | 100   |          |          | 100       |             |               |
| A.4   | Blerje vegla pune, lopata, rashel, etj.   | 50  |          |          |           |             | 50            |
| <b>Shuma</b>  |   | <b>12,378</b>   |          |          | 100       |             | <b>12,278</b> |
| <b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2023</b>  |   | Totali<br>(mijë lekë)   | Nga kjo: |          |           |             |               |
|   |   |   | Paga     | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale      |
| A.1   | Investim për sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor ("capping") të ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Dëshmoreve. | 8,487   |          |          |           |             | 8,487         |
| <b>Shuma</b>  |   | <b>8,487</b>  |          |          |           |             | <b>8,487</b>  |
| <b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2024</b>  |   | Totali<br>(mijë lekë)   | Nga kjo: |          |           |             |               |
|   |   |   | Paga     | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale      |
| A.1   | Investim për sistemimin dhe izolimin sipërfaqësor ("capping") të ish fushës së vend-depozitimit të mbetjeve urbane tek Varrezat e Dëshmoreve. | 8,487   |          |          |           |             | 8,487         |
| <b>Shuma</b>  |   | <b>8,487</b>  |          |          |           |             | <b>8,487</b>  |
| <b>f) Periudha e zbatimit</b><br>Janar 2022 – Dhjetor 2022<br>Janar 2023– Dhjetor 2023<br>Janar 2024 – Dhjetor 2024 |   | <b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b><br>Drejtorja e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave<br><b>Institucion Likujdues:</b> Bashkia Shkodër |          |          |           |             |               |